



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 58

Datë: 04.12.2020. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës të Veriut, të mbajtura më datën 29 nëntor 2020.
3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur, e hapim mbledhjen e 58-të! E kemi një pikë të rendit të ditës: certifikimin e rezultateve. Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

- 2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës të Veriut, të mbajtura më datën 29 nëntor 2020.**

Valdete Daka: Unë, e hedh në votim...sepse, i kemi rezultatet...Nga PZAP kemi marrë konfirmimin se nuk ka ndonjë ankesë...! Bashkangjitur është shkresa, pra mundemi me i certifikua rezultatet...Fillimisht, për komunën e Podujevës:

Kush është për certifikimin e rezultateve për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës...?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për, miratuan certifikimin e zgjedhjeve në këtë komunë.

Valdete Daka: Kush është për certifikimin e rezultateve për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës së veriut ?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për, miratuan certifikimin e zgjedhjeve në këtë komunë.

Të ndryshme !

Në të “ndryshme”, u diskutua lidhur me “vazhdimin” dhe “mos vazhdimin” e kontratave të stafit të angazhuar jo permanent...

Alim Rama, kërkoi që të bëhet një rekapitullim i procesit zgjedhor, në kontekst të “mësimeve të nxëna”...